



International
Labour
Organization

Projekti “Adresimi në Nivel Lokal i Sfidës së Punësimit të të Rinjve në Shqipëri”

THIRRJE PËR APLIKIME

Formalizmi i punësimit nëpërmjet përmirësimit të ndërmarrjeve rurale

Bletaria në rajonin e Kukësit

I. Vështrim i përgjithshëm

Projekti për Adresimin në Nivel Lokal të Sfidës së Punësimit të të Rinjve i financuar nga SDC (Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) vlerëson rolin kyç që autoritetet rajonale/lokale mund të luajnë në trajtimin e sfidave të tregjeve lokale të punës, si edhe masat e ndërmarra nga institucionet qendrore. Bazuar në eksperiencën e mëparshme në kuadrin e Projektit të Përbashkët të OKB për Punësimin dhe Migrimin e të Rinjve (PMR), kjo ndërhyrje synon konsolidimin dhe zgjerimin e përfshirjes së komuniteteve lokale në përpjekjet për zgjidhjen e problemeve të papunësisë. Paktet Territoriale të Punësimit (PTP) përfaqësojnë një risi institucionale e cila është e bazuar në konsultime dhe në planifikim të negociuar midis aktorëve publikë dhe privatë në nivel kombëtar dhe lokal, aktorë të cilët bashkohen për hartimin e objektivave të punësimit duke e vënë theksin tek formalizimi i punëtorëve të rinj dhe krijimi i vendeve të punës.

Paktet projektohen si partneritete nga poshtë-lart me qëllim që të nxisin iniciativat dhe skemat që e trajtojnë papunësinë që në rrënjë. Në të njëjtën kohë masat e PTP-së mbështesin politikat të cilat shënjestrojnë zhvillimin dhe formalizimin e sektorit të bujqësisë duke promovuar formalizimin e ndërmarrjeve të vogla (mikro), veçanërisht në zonat e thella.

Ngritja dhe funksionimi i Bordeve Rajonale të Punësimit, të cilët institucionalizojnë rrjetet e aktorëve lokalë, e rrit besimin në lidhje me mundësinë e përsëritjes së këtij modeli përtej kohëzgjatjes së projektit. Modeli i PTP, si instrument efikas i cili mundëson nxitjen e mënyrave të reja të bashkëpunimit dhe ndërveprimit, është duke u

rimarr në qarkun e Kukësit dhe Shkodrës dhe po testohet për herë të parë në qarkun e Lezhës. Qasjet e reja ndaj problemit kompleks të papunësisë, njohuritë teknike mbi praktikat lokale dhe mësimet e nxjerra mund të shërbejnë edhe përtej kohëzgjatjes së Projektit dhe gjithashtu mund t'ju vijnë në ndihmë edhe aktorëve dhe subjekteve të tjera vendore, të cilët synojnë të kryejnë ndërhyrje të të njëjtit lloj,

Një nga masat e Paktit Territorial të Punësimit në rajonin e Kukësit është formalizimi i punësimit nëpërmjet përmirësimit të ndërmarrjeve rurale në sektorin e bletarise. Kjo masë synon mbështetjen e punësimit të të rinjve dhe zhvillimin e aftësive përkatëse në këtë sektor.

2. Aktivitetet

Shumë familje në Kukës aktualisht praktikojnë bletarine, duke e konsideruar si një burim të mundshëm për gjenerimin e të ardhurave. 6,000 është numri i përllogaritur i koshereve të cilat kontribuojnë në prodhimin vjetor prej afërsisht 90 ton mjaltë. Cilësia e mjaltit, veçanërisht e atij të gështenjës është e një cilësie të lartë. Një numër prej 350 bletërritësish janë zyrtarisht të organizuar në Shoqatën e Bletërritësve në Rajonin e Kukësit. Kjo shoqatë është e pranishme në të tre qarqet e këtij rajoni.

Kontrolli i cilësisë, paketimi, branding dhe marketing-u janë identifikuar si fusha prioritare nga auditi territorial si për zhvillimin e prodhimit ashtu edhe për gjenerimin e shtysave për formalizim të aktivitetit.

Aktivitetet e mëposhtme synojnë arritjen e objektivave të kësaj mase:

1. Projekti do të mbështesë Shoqatën e Bletërritësve të Rajonit të Kukësit për krijimin e një marke për mjaltin e prodhuar në Kukës, duke përcaktuar mekanizmat e kontrollit të cilësisë dhe duke ngritur kapacitetet për paketim dhe marketing.
2. Identifikimi i 20 familjeve të gatshme për t'u marrë me bletërritje dhe prodhimin/tregtimin e mjaltit si një burim shtesë për gjenerim të ardhurash. Secilës familje do t'i ofrohet një shumë prej USD 975, si grant për blerjen e 4 koshereve. Numri i koshereve do të jete kontribut i perbashket i projektit bashke me familjet e interesuara. Kusht për pjesëmarrje do të jetë zotërimi i një cope toke nga ana e aplikantit ku të mund të vendosë këto koshere si dhe të ketë në zotërim të pakten 2 koshere. Përveç kësaj, familjet përfituese duhet të angazhohen për formalizimin e vetëpunësimit të të paktën një anëtarit të familjes (mundësisht të një të riu të moshës 15-29 vjeç- mashkull/femër) si edhe për regjistrimin e aktivitetit për të paktën një vit.
3. Trajnimi do t'u ofrohet familjeve pjesëmarrëse në lidhje me procesin e prodhimit të mjaltit në tërësi, duke përfshirë edhe kontrollin e cilësisë dhe marketing-un.

3. Modalitetet e përzgjedhjes

4. Identifikimi dhe përzgjedhja e 20 familjeve të gatshme për t'u marrë me bletari dhe prodhim/tregtim mjalti si një burim shtesë për gjenerim të ardhurash do të bëhet nëpërmjet thirrjes aktuale për aplikime. Kusht për pjesëmarrje do të jetë zotërimi i një cope toke nga ana e aplikantit ku të mund të vendosë këto koshere. Përveç kësaj, familjet përfituese duhet të angazhohen për formalizimin e vetëpunësimit të të paktën një anëtari të familjes (mundësisht të një të riu të moshës 15-29 vjeç- femër/ mashkull) si edhe për regjistrimin e aktivitetit për të paktën një vit.

4. Pjesëmarrësit e mundshëm

- Aplikantët duhet të jenë banues në rajonin e Kukësit;
- Ato duhet të jenë të gatshëm për të ndërmarrë aktivitetin e bletarise dhe prodhimit të mjaltit si një burim shtesë për gjenerim të ardhurash;
- Kanë në pronësinë e tyre një pjesë toke të mjaftueshme për vendosjen e koshereve si dhe të paktën 2 koshere.
- Janë të gatshëm të formalizojnë vetëpunësimin e të paktën një anëtari të familjes (mundësisht të një të riu të moshës 15-29 vjeç - mashkull/femër) si edhe të regjistrojnë aktivitetin e tyre për të paktën një vit.

Afati i fundit: Aplikimet duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në dy kopje jo më vonë se dita e enjte, datë 20 mars 2014 në orën 12.00 në adresën e mëposhtme:

Z. Bukurosh Onuzi
Koordinator Rajonal për Kukësin
Adresa: Këshilli Rajonal i Kukësit
E-mail: buabon@yahoo.com
Cel: +355 692096645